



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 03.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., e dt.03.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 26.06.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 26.06.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.03.07.2023, Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", Nr. i prokurimit- 632-23-4357-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-053 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta lidhur me inxhinieret Ismet Berisha dhe Bexhet Baftjaraj, nuk qëndron sepse inxhinieri i Operatorit ekonomik NBT-ING, Bexhet Baftjaraj, është e vërtetë se ka edhe një punë të dytë, por njëra është sekondare e tjetra primare.

Edhe inxhinieri Ismet Berisha, po ta kishte një punë primare e tjetrën sekondare, autoriteti kontraktues do ta merrte si të mirëqenë(sepse një person nuk mund t'i ketë në të njëjtën kohë dy punë primare).

Pretendimi juaj lidhur me atë se Operatori ekonomik NBT-ING ,është betuar rrejshëm duke plotësuar Deklaratën nën betim është i pa bazuar, sepse Operatori ekonomik në fjalë, ka sjellë dokumentet e kërkuara nga Autoriteti kontraktues gjegjësisht Vërtetimin e Gjykatës (njejte si gjithë Operatorët tjerë ekonomik).

Gjithashtu sqarojmë se Deklarata nën betim është plotësuar nga Bexhet Baftjaraj, i cili emër figuron edhe te Çtifikata e biznesit(dmth se pronari është ndërruar- nuk është më Tahir Sopa).



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD – COMMERCIAL COURT

GjA.nr.1992-23
24.04.2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, në bazë të kërkesës së palës në kuptim të Rregullores Nr.07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale të datë 29.07.2022, lëshon këtë: *PRIVREDNI SUD KOSOVA, na osnovu zahteva stranke u smislu Uredbe 07/2022 o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih, Mesta u Privrednom Sudu od 29.07.2022, izdaje ovo:*

ÇERTIFIKATË
UVERENJE

Në regjistrat e Gjykatës Komerciale të Kosovës, *U registrima Privrednog suda Kosova* Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **NBT – ING SH.P.K. Suharekë** me numër të regjistrimit **810636805** është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është e iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit. *Nema dokaza da je ekonomski operator, sa brojem biznisa, proglašen pod stečajem ili nesolventan u protekle dve godine, i protiv istog, pokrenut postupak stečaja odnosno stečaja likvidacije*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. *Ovo Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesëmarrjes në **Tender** dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera. *Ista je zatražena od stranke s ciljem učesća za Tender, i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej pesë (5) €, e paraparë me nenin 12.17 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017. *Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5€, predviđeno članom 12.17 Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017 god.*



Numri i Prokurimit: 632-23-4357-521 – Titulli Renovimi dhe adaptimi i shkollës Zef Lush Marku-Brekoc.

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: ["NBT-ING" SHPK] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OEt	"NBT-ING" SHPK
Adresa e plotë	Bigada 123 Pn-Suharekë
Ipërfaqësues i ngjar	
Emri	Bexhet Baftjaraj
Pozita	Drejtuës Ligjor
Nënshkrimi	
Data	26.05.2023
Nëmbi	



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

4211	Aktivitetet tjera	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave Construction of roads and motorways Izgradnja puteva i autoputeva
4291	Aktivitetet tjera	Ndërtimi i projekteve të ujit Construction of water projects Izgradnja vodnih građevina
4312	Aktivitetet tjera	Përgatitja e vendpulishtes Site preparation Priprema radova na gradilištu
4313	Aktivitetet tjera	Testi i shpuarjes dhe shpuarja Test drilling and boring Probno bušenje ,ispitivanje i sondiranje terena za gradnju
4321	Aktivitetet tjera	Instalime elektrike Electrical installation Elektroinstalacijski radovi
4322	Aktivitetet tjera	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit Plumbing, heat and air-conditioning installation Uvođenje instalacija vodovoda, kanalizacije i plina i instalacija za grejanje i klimatizaciju

Fillalet / Branches / Jedince

Bordi drejtorëve / Board of Directors / Upravni odbor

Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Bexhet Baftjaraj
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1002477617
Adresa: Address: Adresa:	Sopljë Sopljë Suharekë, Kosova
Përgjegësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesë në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	13,000.00€
Data: Date: Datum:	28/11/1977



Akcionar / Shareholder / Akcionarsko



Akcionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlaścene lce

Emri: Name: Ime:	Bexhet Baftjara
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1002477617
Pozita e punës: Job position: Radno mesto:	Drejtore menaxhues
Adresa: Address: Adresa:	Sopljë Sopljë Suharekë, Kosova
Autorizimet: Authorizations: Autorizacije:	Përfaqësues i autorizuar

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik NBT-ING nuk e plotëson kapacitetin ekonomik, nuk qëndron, sepse ky operator ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Gjithashtu operatori ekonomik në fjalë ka prezantuar listën e punëtorëve, e cila e tejkalon numrin prej 15 punëtorëve të kërkuar në FDT-ë, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron, ashtu si nuk qëndron pretendimi tjetër i juaji lidhur me stafin profesional, e posaçërisht me përvojën e inxhinierit Bexhet Baftjara, sepse edhe të qenit drejtor në një kompani llogaritet përvojë e punës.

Pretendimi juaj lidhur me Ing.Kujtim Suka, nuk qëndron, sepse i njëjti sipas CV-së se prezantuar ka përvojë të punës më shumë se 5 vjeçare.

Sa i përket ing.Gafurr Dakaj dhe Hekuran Demiri, pretendimi juaj është i pa bazuar, sepse të njëjtit kanë vetëm një punë primare e të tjerat sekondare, kurse inxhinieri juaj i ka prezantuar dy punë primare gjë e cila nuk është e mundur praktikisht dhe as e lejuar ligjërisht.

Pretendimi juaj lidhur me Ing.Eqrem Kryeziu , nuk qëndron, sepse për inxhinierin e hidros dhe gjeodezisë nuk është kërkuar përvoja e punës.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me çmimet, Autoriteti kontraktues sqaron se Operatorit ekonomik në fjalë përmes Letrës standarde për çmime jo normalisht të ulëta i është kërkuar një deklaratë ku do të zbërthente kalkulimin e çmimit të paraqitur. Operatorit ekonomik ka prezantuar deklaratën e kërkuar ku ka sqaruar se qëndron pran çmimeve të prezantuara dhe kjo është e mjaftueshme për Autoritetin kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës